

William R. Hite, Jr., Ed.D.
Superintendent

26 Gusht 2020

Përshëndetje familjarë të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias,

Dita e parë e shkollës, 2 Shtatori, është vetëm një javë larg. Unë po shkruaj për t'ju dhënë informacione të reja dhe për t'ju ndihmuar ju dhe familjen tuaj të përgatiteni për fillimin e shkollës, me të gjithë studentët e angazhuar në mësimin dixhital me mësuesit nga shkolla e tyre të regjistruar.

Tani mund të hyni në informacionin më të fundit për shkollën, duke vizituar filasd.org/backtoschool. Aty do të gjeni informacione, udhëzime dhe burime të rëndësishme për të siguruar që familja juaj të jetë e gatshme të fillojë vitin shkollor, duke përfshirë:

- **Një listë të familjes " Back - to - School"** - për t'ju ndihmuar të organizoheni,
- **Një udhëzues për frekuentimin dhe vlerësimin** - për kërkesat e këtij viti dhe si mund të ndihmoni për frekuentimin e fëmijës suaj në shkollë,
- **Informacione për Chromebook** - duke përfshirë vendet dhe orët e funksionimit të Qendrës " Family Tech Center", si dhe udhëzimet hap pas hapi se si të hyni dhe të përdorni pajisjet,
- dhe shumë më shumë

Unë gjithashtu dua t'ju njoftoj për ndryshimet në mënyrën se si do të shpërndajmë ushqimin e studentëve dhe si do t'i mbështesim nevojat sociale-emocionale të nxënësve tanë pasi të fillojë shkolla.

Ushqimi për Studentët

Departamenti i Bujqësisë në SH.B.A. kërkon tani që Drejtoria Arsimore të sigurojë ushqime vetëm për studentët e regjistruar në shkollat e tyre. Kjo do të thotë që, **duke filluar nga dita e Enjte, 3 Shtator**, kush kërkon të marrë kuti me ushqime për studentët në cilindo nga 62 vendet e shpërndarjes së vaktit të Drejtorisë është e nevojshme të sigurojë një numër identifikimi të studentit / ID për secilin student. Një listë e plotë e vendeve të shpërndarjes së vaktit të ushqimit mund ta shikoni në philasd.org/grab-go-meals. Fëmijët që nuk janë regjistruar në Drejtorinë Arsimore të

Filadelfias mund të marrin vakte ushqimi nga vendet e caktuara nga qyteti, i listuar në phila.gov/food.

" Healing Together"

Për të ndihmuar në adresimin e nevojave të studentëve dhe familjeve në vazhden e një traume të qëndrueshme, Drejtoria po paraqet inisiativën " Healing Together". si pjesë e përpjekjes, të të gjithë studentëve të marrin pjesë në takime të komunitetit me mësuesit dhe bashkëmoshatarët e tyre dhe të përfshihen në aktivitete mësimore-emocionale dhe aktivitete për krijimin e marrëdhënieve gjatë gjithë ditës. Për shëmbull, mësuesit mund të prezantojnë ushtrime të krijuara për t'i ndihmuar studentët të administrojnë dhe rregullojnë shumë gjendjen emocionale që mund të jenë duke përjetuar. Mësuesit dhe këshilltarët do të punojnë së bashku për të identifikuar nxënësit që kanë nevojë për mbështetje shtesë, në partneritet me familjet për të identifikuar më shumë mënyra dhe për të ndihmuar në lidhjen e studentëve dhe familjeve me shërbime të tjera mbështetëse, sipas nevojës. Një ofrues i shëndetit të sjelljes gjithashtu do t'i caktohet secilës shkollë për të siguruar mbështetje shtesë. Mund të mësoni më shumë rreth " Healing Together " [këtu](#).

Së fundi, " Our Back - to - School - Drive - Thru Backpack Giveaway " është ditën e Premte, 28 Gusht nga ora 9 e mëngjesit - 1: 00 pasdite në Lincoln Financial Field , Lot K. Për më shumë informacione, vizitoni philasd.org/face/backpacks.

Ne jemi të gatshëm për të mirëpritur të gjithë të rinjtë tanë përsëri në shkollë më 2 Shtator .Duke punuar së bashku, ne mund të mbështesim një vit shkollor 2020 - 2021 të sigurt dhe të suksesshëm për të gjithë.

Sinqerisht,



William R. Hite Jr., Ed.D.
Superintendent
Drejtoria Arsimore e Filadelfias